



KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

INFORMIM DHE PRIVATËSI

Revista Nr. 12

PËRMBAJTJA

Të dhëna të sigurta, ura bashkëpunimi, kufij të zgjeruar-Ceremonia e Mbylljes së Projektit të Binjakëzimit

Asambleja Globale e Privatësisë (GPA), edicioni i 43-të

Zyra e Komisionerit në Asamblenë Globale të Privatësisë

28 Shtator-Dita e të Drejtës për Informim, transparenca proaktive e Autoriteteve Publike të sektorit shëndetësor

Staf i trajnuar për mbikëqyrje efektive të kuadrit të ri rregullator për mbrojtjen e të dhënave personale

Aktivitete për njohjen e kuadrit të ri rregullator të mbrojtjes së të dhënave personale me kontrollues publik e privat

Konsultimi publik për projektligjin e ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe përmirësimet e ligjit “Për të drejtën e informimit”

Transparenca proaktive e Autoriteteve Publike

Raporti i Monitorimit për Shqipërinë nga SIGMA, “Parimet e Administratës Publike”

Mbrojtja e të dhënave personale, liri dhe e drejtë e çdo qytetari

Ambasadori gjerman në Shqipëri viziton Zyrën e Komisionerit

Takimi i 21-të i CEEDPA

Forcimi i bashkëpunimit me autoritetin homolog të Kosovës

Transparencë në veprimtarinë e Prokurorisë

Njohja dhe ndërgjegjësimi për ushtrimin e të drejtave, takim me gjimnazistë

Balanca mes dy të drejtave në veprimtarinë e Autoriteteve Publike të sektorit shëndetësor

Bashkëpunim me IAL për ndërgjegjësimin e studentëve

“Edukimi digjital, luaj dhe mëso-Happy onlife”, Fushata Kombëtare për ndërgjegjësimin e nxënësve

Revista “Informim Dhe Privatësi”

Redaksia: Redi Skënderaj, Alketa Koja, Segi Berberi, Elinda Sulejmani, Denada Hysi

Nr. 12
Dhjetor 2021

Design e shtyp
ONUFRI

TË DHËNA TË SIGURTA, URA BASHKËPUNIMI, KUFIJ TË ZGJERUAR – CEREMONIA E MBYLLJES SË PROJEKTIT TË BINJAKËZIMIT

Zyra e Komisionerit dhe Bashkimi Evropian zhvilluan Ceremoninë e Mbylljes së Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis* të BE”. Në këtë aktivitet të ftuar nderi ishin z. Pasquale Stanzione, President i Autoritetit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Italisë, z. Ulsi Manja, Ministër i Drejtësisë, z. Zef Mazi, Kryenegociator i Shqipërisë për negociatat e anëtarësimit në BE, z. Alexis Hupin, Shef i Seksionit për Integrimin Evropian, Politikën, Shtypin dhe Informimin në Delegacionin e BE, znj. Jutta Gützkow, Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës, z. Stefano Salmoso, përfaqësues i Ambasadës së Italisë dhe znj. Renate Seib, Zëvendësambasadore e Austrisë.




aksione të tjera në punën dhe mbështetjen për Zyrën e Komisionerit, që kjo të mos mbetet si një certifikatë e radhës në kornizë. Ne do të vazhdojmë edhe me pjesën tjetër të legjislacionit të fushës së veprimtarisë së institucionit dhe kam besimin se së shpejti do të përfundojnë edhe procedurat për miratimin e Konventave 108+ dhe 205 të Këshillit të Evropës”.

Komisioneri Dervishi në fjalën e tij theksoi se “kontributi dhe produkti tejet profesional për të tre komponentët ka qenë dhe do të mbetet një shkollë për institucionin e Komisionerit. Transpozimi i GDPR, që do të pasohet nga miratimi i ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale përfaqëson një hap cilësor, por që duhet të pasohet nga

Ky Projekt Binjakëzimi u realizua në tre komponentë: përafrimi i legjislacionit shqiptar në fushën e mbrojtjes së të dhënave me GDPR dhe Direktivën e Policisë; rritja e kapaciteteve institucionale për përmirësimin e mbikëqyrjes, si dhe zgjerimi i njohurive e ndërgjegjësimi i kontrolluesve dhe përpunuesve për përmbushjen e detyrimeve të kuadrit të ri rregullator. Pjesëmarrësit në takim vlerësuan frymën e bashkëpunimit miqësor dhe të koordinimit mes partnerëve të Projektit.



ASAMBLEJA GLOBALE E PRIVATËSISË (GPA), EDICIONI I 43-TË



Në datat 18-21 tetor 2021 u mbajtën punimet e edicionit të 43-të të Asamblesë Globale të Privatësisë (*Global Privacy Assembly-GPA*). Aktiviteti më i rëndësishëm vjetor i kësaj fushe u zhvillua në një format hibrid – online dhe fizikisht, kushtëzua nga situata me pandeminë COVID-19 dhe u organizua nga Instituti Kombëtar për Transparencën, Informacionin dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Meksikës (*National Institute for Transparency, Access to Information and Personal Data Protection-INA*).

Në Sesionin e Mbyllur të GPA morën pjesë përfaqësues nga 153 Autoritete anëtare dhe vëzhguese të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë nga e gjithë bota. I mbajtur në datat 20-21 tetor, në të u miratuan 5 dokumente, ku Zyra e Komisionerit ka dhënë kontributin e saj në cilësinë e anëtares së Komitetit Ekzekutiv dhe në 3 Nën-komitete të kësaj organizate:

- *Rezoluta për të ardhmen e Asamblesë Globale të Privatësisë* (Zyra e Komisionerit është bashkë-propozuese);
- *Rezoluta për planin strategjik 2-vjeçar* (Zyra e Komisionerit është bashkë-propozuese);
- *Rezoluta për shkëmbimin e të dhënave për të mirën publike;*
- *Rezoluta për aksesin e qeverisë në të dhëna;*
- *Rezoluta për të drejtat digjitale të fëmijëve.*


Në punimet e Sesionit të Mbyllur pjesëmarrësit diskutuan për tematika dhe çështje që kanë të bëjnë me “qarkullimin e të dhënave dhe inovacionin” apo me “mësimet e përfituara nga pandemia Covid-19”. Po ashtu u trajtuan, nëpërmjet shembujve konkretë, përvoja e anëtarësisë në “bashkëpunimin ndërkombëtar për zbatimin e ligjit dhe shkëmbimin e eksperiencës” dhe për “nxitjen e inovacionit përmes angazhimit”; ndërsa u prezantuan e miratuan raportet vjetore të Grupeve të Punës së GPA, si dhe nga disa organizma partnere.



Në Sesionin e Mbyllur znj. Blanca Lilia Ibarra Cadena, Komisionere e Autoritetit të Meksikës u zgjodh në krye të Komitetit Ekzekutiv të GPA me një mandat 2-vjeçar. Ajo zëvendëson në këtë detyrë znj. Elizabeth Denham, Komisioneren e Britanisë së Madhe.

Në Asamblenë Globale të Privatësisë u anëtarësuan me të drejta të plota Zyra e Komisionerit të Informimit të Kuinslendit në Australi dhe Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave të Fondit të Tregut Botëror të Abu Dabit. Nga ana tjetër, statusin e vëzhguesit në GPA e morën 8 institucione dhe organizata: Autoriteti Kombëtar i Mbrojtjes së të Dhënave të Brazilit; Bordi i Privatësisë e të Drejtave Civile dhe Byroja për Mbrojtjen Financiare të Konsumatorit nga Shtetet e Bashkuara; Autoriteti i të Dhënave dhe Inteligjencës Artificiale të Arabisë Saudite; Ministria e Transportit e Komunikacionit dhe Zyra e Mbrojtjes së të Dhënave të Qendrës Financiare nga Katari; Forumi i Autoriteteve të Privatësisë Azi-Paqësor; si dhe Instituti Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut.

Për herë të parë, GPA ka akorduar Çmimin “Giovanni Buttarelli” për kontributin e shquar në këtë fushë znj. Shoshana Zuboff, profesore në Shkollën e Biznesit të Universitetit të Harvardit në SHBA, për bashkëautorësinë e librit “Në epokën e mbikëqyrjes kapitaliste” (*In the age of surveillance capitalism*). Çmimi synon të njohë kontributin e çmuar të z. Buttarelli në mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë, si një udhëheqës dhe si një avokat i bashkëpunimit ndërkombëtar. Ai u nda nga jeta më 21.08.2019 teksa ushtronte detyrën e Supervisorit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave (EDPS).



Sesioni i Hapur, i zhvilloi punimet në datat 18-19 tetor, me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të botës akademike, shoqërisë civile apo biznesit, së bashku me ata nga autoritetet anëtare/vëzhguese të GPA, ku u trajtuan tematika dhe çështje me interes dhe mjaft aktuale për komunitetin e profesionistëve të fushës e jo vetëm. I ndarë në 5 panele kryesore, në këtë pjesë të Asamblesë u diskutua për “mbrojtjen e të dhënave dhe të drejtat e njeriut,


survejinin masiv nëpërmjet njohjes së fytyrës dhe analizën e të dhënave masive”, si dhe për “*promovimin e qasjes etike në funksionimin e organizatave*”. Gjithashtu, u trajtuan nga të pranishmit edhe temat “*e ardhmja e privatësisë dhe teknologjisë, sfidat dhe zgjidhjet e mundshme*”; “*sfidat e përputhshmërisë, perspektiva e veprimtarisë së personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale (DPO)*”, si dhe në lidhje me “*statusin e Konventës 108+ të Këshillit të Evropës dhe mundësinë për hartimin e një Traktati për Inteligjencën Artificiale*”.

Edicioni i 44-t i GPA në vitin 2022 është vendosur të organizohet nga Autoriteti Turk i Mbrojtjes së të Dhënave Personale (Kişisel Verileri Koruma Kurumu–KVKK).

Zyra e Komisionerit mori pjesë në punimet e edicionit të 43-të të Asamblesë Globale të Privatësisë (GPA) në panelin me temë “*Bashkëpunimi ndërkombëtar për zbatimin e ligjit dhe shkëmbimi i eksperiencës*”.

Në të, Zyra e Komisionerit u përfaqësua nga znj. Besa Velaj, Drejtore e Kabinetit, ndërsa referuan edhe përfaqësues të Autoriteteve homologe nga Britania e Madhe, Australia, Japonia, Kolumbia, Hong Kongu dhe Gana.

Znj. Velaj solli përvojën e bashkëpunimit me Autoritetin Italian të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (*Garante per la Protezione dei Dati Personali*) në zhvillimin e hetimeve të përbashkëta, me fokus zbatimin efektiv të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Panelistët vlerësuan eksperiencën e prezantuar nga Zyra e Komisionerit, ndërsa theksuan se bashkëpunimi dy ose shumëpalësh për zbatimin e ligjit është rruga më e mirë për adresimin e problematikave që sjell zhvillimi ekonomik, veçanërisht përparimi teknologjik i viteve të fundit.



28 SHTATOR-DITA E TË DREJTËS PËR INFORMIM, TRANSPARENCA PROAKTIVE E AUTORITETEVE PUBLIKE TË SEKTORIT SHËNDETËSOR



Transparenca proaktive e Autoriteteve Publike të sektorit shëndetësor ishte tematika e aktivitetit të organizuar nga Zyra e Komisionerit me rastin e 28 Shtatorit – Ditës së të Drejtës për Informim. Në aktivitet morën pjesë të ftuarit e veçantë znj. Eugena Tomini, Zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Albana Fico, Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Shëndetit Publik, znj. Mirela Cami, Drejtor i Përgjithshëm i Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, z. Skënder Brataj, Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Kombëtare të

Urgjencës Mjekësore dhe përfaqësues e koordinatorë të të drejtës për informim nga institucione publike të sistemit shëndetësor nga i gjithë vendi.

Z. Besnik Dervishi, në fjalën e tij tha se është në vëmendjen e Zyrës veprimtaria e këtyre Autoriteteve Publike përgjatë situatës me pandeminë COVID-19. “Në këtë aktivitetet kemi ftuar institucionet që kanë përballuar peshën kryesore në këtë periudhë të pazakontë, me të cilat kemi bashkëpunuar ngushtësisht dhe i kemi mbështetur për të siguruar transparencën e veprimtarisë së tyre dhe zbatimin e të drejtës për informim” – theksoi Komisioneri.

Në këtë takim u trajtua zbatimi i ligjit për të drejtën e informimit gjatë kësaj periudhe nga Autoritetet Publike në sektorin e shëndetësisë. Programet e transparencës janë instrumenti më i rëndësishëm për transmetimin e informacionit në publik apo në grupet e interesit, ashtu si edhe trajtimi i kërkesave për informacion në afat dhe në përmbajtje, si dhe fuqizimi i rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit në strukturën e Autoritetit Publik.



STAF I TRAJNUAR PËR MBIKËQYRJE EFEKTIVE TË KUADRIT TË RI RREGULLATOR PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE



Zyra e Komisionerit zhvilloi një vizitë studimore si pjesë e programit të trajnimeve për komponentin “*Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e kuadrit ligjor të mbrojtjes së të dhënave personale*” të Projektit të Binjakëzimit “*Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me acquis-in e BE*”. Ky aktivitet u mbajt online me përfaqësuesit e

institucioneve zbatuese të Projektit nga Autoriteti Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, instituti austriak “Për të drejtat e njeriut Ludwig Boltzmann” dhe CSI-Piemonte në Itali.

Në dy ditët e para, trajnimi kishte në fokus historikun e krijimit, rolin dhe funksionimin e Autoritetit homolog italian, veçanërisht, detyrat e departamentit të teknologjisë së informacionit, si dhe kompetencat dhe organizimin e hetimit administrativ. Po ashtu, u diskutua edhe për tematika që kanë të bëjnë me koncepte si “*privatësia kundrejt mbrojtjes së të dhënave*”, median dhe rrjetet sociale, sektori i telekomunikacionit dhe marketingu apo bullizmin kibernetik. Në gjysmën e dytë të trajnimit, vëmendja u përqendrua në eksperiencën austriake të zbatimit të legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale. Lektorë ishin ekspertë të njohur të fushës nga ministritë e Drejtësisë dhe të Brendshme dhe nga gjykatat Administrative Supreme dhe Federale. Nëpërmjet rasteve praktike u trajtua jurisprudenca dhe vendimmarrja e akumuluar nga institucionet përkatëse, duke e vënë theksin te rritja e përgjegjshmërisë së kontrolluesve/përpunuesve.

Ndërsa në një sesion trajnues, stafi i Zyrës u njoh me shembuj nga zbatimi i kuadrit rregullator në vendet e BE. Në të u trajtuan kompetencat e autoritetit mbikëqyrës, zhvillimi i hetimeve administrative kur përfshihen dy e më shumë institucione homologe, si dhe ndarja e përgjegjësisë në të tilla raste. Të pranishmit u njohën me funksionimin e Bordit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave dhe me rolin që luan ky organizëm në bashkëpunim mes autoriteteve kombëtare. Vëmendje iu kushtua edhe çështjeve që kanë të bëjnë me “*të drejtën për t’u harruar*” (*right to be forgotten*) dhe procesin e portabilitetit të të dhënave, si dy nga risitë e GDPR, me synim ndërjegjësimin e qytetarëve për ushtrimin në praktikë të të drejtave të tyre.



AKTIVITETE PËR NJOHJEN E KUADRIT TË RI RREGULLATOR TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE ME KONTROLLUES PUBLIK E PRIVAT




Zyra e Komisionerit në periudhën korrik-nëntor 2022 zhvilloi 10 webinar-e (*dissemination events*) në kuadër të zbatimit të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis-in e BE*”.

Aktivitetet u zhvilluan me kontrollues që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre si në sferën publike ashtu edhe në atë private. Në trajnime morën pjesë mbi 500 përfaqësues nga sektori shëndetësor; ai bankar/financiar e telekomunikacionit; nga institucione të administratës

publike; nga policia, prokuroria, gjykatat dhe Shkolla e Magjistraturës; nga organizata të shoqërisë civile dhe medias; nga institucione të arsimit të lartë; nga profesionet e lira (avokatë, noterë e përmbarues gjyqësor); nga institucionet të pavarura/shtetërore që ofrojnë shërbime në rrugë elektronike nëpërmjet sistemeve TIK apo parti politike që përpunojnë të dhëna personale në kuadër të veprimtarisë së tyre; si dhe me nxënës e mësues të arsimit parauniversitar.





Trajnimet kishin në vëmendje prezantimin e legjislacionit të ri kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale të përafuar plotësisht me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) dhe me Direktivën “Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” (e njohur si Direktiva e Policisë). Nëpërmjet krahasimit me shembuj nga praktika u diskutua për detyrimet që burojnë nga zbatimi i tij në kuadër të veprimtarisë së kontrolluesit sipas sektorëve/fushave specifike. Përveç se trajnime me karakter njohës e informues, ato kishin në fokus ndërgjegjësimin për garantimin e plotë të të drejtave të qytetarëve në procesin e mbledhjes/përpunimit të të dhënave të tyre personale, si një kontribut në forcimin e funksionimit të sistemit demokratik dhe shtetit ligjor. Trajnimi u zhvilluan nga ekspertë e Autoritetit homolog italian, të institutit “Ludwig Boltzmann”, CSI-Piemonte në Itali dhe të Zyrës së Komisionerit.



KONSULTIMI PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN E RI “PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE” DHE PËRMIRËSIMET E LIGJIT “PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT”

Zyra e Komisionerit ka iniciuar procesin e konsultimit publik për dy akte: projektligjin e ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014, datë 14.09.2014, “Për të drejtën e informimit”.

Kuadri i ri rregullator në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale është rezultat i zbatimit të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis e BE*”, duke përafuar Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR) dhe Direktivën e Policisë. Ligji i ardhshëm parashikon standardet më të larta për qytetarët shqiptarë në garantimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, duke marrë në konsideratë, sidomos, zhvillimet teknologjike të dy dekadave të fundit. Njëkohësisht, kjo reformë ligjore është një hap konkret në procesin e integritimit të vendit në Bashkimin Evropian.




Zyra e Komisionerit, duke patur në fokus ushtrimin në praktikë të të drejtës për informim dhe rritjen e transparencës e llogaridhënies së Autoriteteve Publike, ka hartuar projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014, datë 14.09.2014, “Për të drejtën e informimit””. Këto përmirësime kanë për qëllim të forcojnë rregullat dhe procedurat e legjislacionit aktual, duke reflektuar problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të tij dhe gjithashtu, sugjerimet/propozimet e organizatave të shoqërisë civile e qytetarëve. Ky projektligj është përgatitur më herët nga Zyra e Komisionerit, por iniciimi i kësaj nisme në këtë moment, vjen si pasojë e ndryshimeve paralele rregullatore në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Të dy këto projektakte i konsultoni në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Komisionerit.

TRANSPARENCA PROAKTIVE E AUTORITETEVE PUBLIKE

Zyra e Komisionerit organizoi dy takime në funksion të përmirësimit të transparencës proaktive dhe rritjes së llogaridhënies së Autoriteteve Publike qendrore dhe atyre të vetëqeverisjes vendore.

Aktiviteti i organizuar me Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive dhe koordinorët e të drejtës për informimit të këtyre institucioneve pati në fokus përmbushjen e detyrimeve ligjore për garantimin e të drejtës për informim dhe funksionalizimin e plotë të Programit të Transparencës, sipas modelit të miratuar në 18.12.2020. Objekt diskutimi ishin konstatimet e Zyrës së Komisionerit gjatë monitorimeve të kryera, ku kryesisht problematik mbetet plotësimi me informacion i të gjithë rubrikave të Programit të Transparencës. Ky instrument është nga burimet kryesore të informacionit për publikun apo grupet e interesit dhe shpreh nivelin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së Autoriteteve Publike. Në takim u trajtua edhe çështja e përmirësimit të procesit të kthimit të përgjigjeve për kërkesat për informacion në afat dhe në përmbajtje, ndërsa, u theksua edhe forcimi i rolit të koordinorit nëpërmjet rritjes së aksesit brenda strukturës së Autoritetit Publik.



Aktiviteti i organizuar me Kryetarët e Bashkive apo funksionarë të tjerë të lartë, si dhe me koordinorët e të drejtës për informim pati në fokus problematika që lidhen me transparencën e njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Programi model i Transparencës për këtë kategori Autoritetesh Publike është i zbatueshëm prej 1 janarit 2019 dhe reflekton veçoritë e tyre në raport me shërbimet që ofrojnë për qytetarët. Nga monitorimet e vazhdueshme konstatohen ende problematika në këtë drejtim, si mosnjohje e duhur e detyrimeve ligjore apo dhe mungesë e angazhimit institucional. Zyra e Komisionerit kërkoi nga titullarët e këtyre institucioneve marrjen e masave dhe sidomos, monitorimin e vazhdueshëm për përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore.

RAPORTI I MONITORIMIT PËR SHQIPËRINË NGA SIGMA, “PARIMET E ADMINISTRATËS PUBLIKE”

SIGMA (*Support for Improvement in Governance and Management*) është një nismë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (*Organisation for Economic Co-operation and Development-OECD*) dhe Bashkimit Evropian. Objektivi i saj kryesor është të forcojë themelet për përmirësimin e qeverisjes publike dhe si rrjedhim, të mbështesë zhvillimin social-ekonomik përmes ndërtimit të kapaciteteve të sektorit publik, përmirësimit të qeverisjes horizontale dhe përmirësimin e hartimit dhe zbatimit të reformave të administratës publike, duke përfshirë priorizimin e duhur, renditjen dhe buxhetimin.



SIGMA ka kryer monitorimin e “Parimeve të Administratës Publike në vendet candidate në BE dhe candidate potenciale që nga viti 2015”. Në vitin 2021, raportet e monitorimit u përgatitën për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Nën parimin e “Llogaridhënies së Administratës Publike”,

SIGMA ka vlerësuar gjatë vitit 2017 dhe vitit 2020 treguesin “E drejta për të aksesuar informacion publik është miratuar në legjislacion dhe zbatohet vazhdimisht në praktikë”. Zbatimi i të drejtës për informim renditet në krye të avancimit të parimeve të reformës në administratën publike dhe në përmbushjen e standardeve të administrimit publik. Fakti evidentohet në raportin më të fundit të realizuar nga SIGMA, vlera për treguesin “Qasja ndaj informacionit publik” është vlerësuar me 4 pikë, në një shkallë 1 deri në 5. Përmirësimi i vlerës së treguesit – që ishte 3 në vitin 2017 – mund t’i atribuohet përmirësimit të perceptimit të transparencës mes qytetarëve dhe bizneseve të raportuara nga Barometri Ballkanik.

Veçanërisht, raporti i SIGMA për vitin 2021 ndalet dhe tek roli i autoritetit, ku konkretisht citohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, luan një rol kyç në monitorimin e standardeve të transparencës të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014. Në veçanti, Komisioneri vepron si një organ apelimi, i cili vlerëson mjetet juridike kundër refuzimit të aksesit në informacion ose heshtjes administrative”. Në shumicën e rasteve të shqyrtuara nga Komisioneri, aplikantët kanë marrë informacionin e kërkuar gjatë procedimit, i cili jep disa dëshmi të rolit të suksesshëm ndërmjetësues të institucionit. Siç tregon edhe anketa WeBER, një pjesë e madhe e popullsisë vlerëson pozitivisht përpjekjet e këtij institucioni në promovimin e transparencës”.

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE, LIRI DHE E DREJTË E ÇDO QYTETARI

Zyra e Komisionerit, në ushtrim të kompetencave të saj monitoruese dhe mbikëqyrëse, ka ndërmarrë procedura në zbatim të legjislacionit në fuqi për raste të cenimit të të dhënave personale të qytetarëve, të verifikuara nga njoftimet në media. Si edhe në raste të tjera të ngjashme, vlerësojmë se ushtrimi i lirisë së shprehjes dhe të shtypit, kur në objekt ka të dhëna personale, para së gjithash, duhet realizuar duke mbajtur parasysh faktin se “interesi i lartë publik” dallon nga “interesi për publikun”.



Në këtë kontekst, u është bërë thirrje të gjithë individëve apo subjekteve publike/private që disponojnë baza të dhënash personale, të mos i transmetojnë, qarkullojnë apo publikojnë, duke rënduar situatën në kuadër të pasojave që mund të vijnë në lidhje me të drejtën për respektimin e jetës private. Çdo veprim që mund të duket si një “lojë”, në përfundim do të rezultonte si shkelje e ligjit, pasi kemi të bëjmë me një përpunim të paligjshëm të të dhënave personale të qytetarëve dhe u bëhet thirrje organeve mediatike dhe publikut të mos bëhen përhapës të paligjshëm të tyre.



Nga ana tjetër, Zyra e Komisionerit ka konstatuar jo pa shqetësim një aktivitet intensiv mediatik, në lidhje me raste të rënda të dhunës ndaj të miturve, për të cilat janë publikuar në media detaje dhe informacione me karakter sensitiv. Mbulimi mediatik duhet të jetë në përputhje me standardet e përgjithshme të mbrojtjes së të drejtës së privatësisë, në veçanti, me parimin e

saktësisë, proporcionalitetit, transparencës dhe në sigurinë e përpunimit të të dhënave personale, sipas kuadrit rregullator ndërkombëtar dhe atij kombëtar (*Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Konventa 108 e Këshillit të Evropës, Kushtetuta e Shqipërisë*). Publikimi i informacioneve personale në media mund të shkaktojë pasoja të pariparueshme dhe të pakthyeshme për të miturit, pasi përveç dhunës fizike të ushtruar ndaj tyre, ata mund të përballen me një dhunë mediatike, e cila për nga përmasa e pasojave është po aq e rëndë sa vetë aktet e dhunës të ushtruar ndaj tyre. E drejta për privatësi nga të miturit është gjithmonë parësore dhe kjo vlen edhe në rastet kur identiteti bëhet i ditur nga burime zyrtare apo nga ato pranë familjes. Mediat duhet të vendosin në radhë të parë interesin më të lartë të fëmijëve në veprimtarinë e tyre informuese.

AMBASADORI GJERMAN NË SHQIPËRI VIZITON ZYRËN E KOMISIONERIT



Komisioneri z. Besnik Dervishi, priti në një takim Ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri, z. Peter Zingraf.


Komisioneri shprehu falënderimin për kontributin dhe mbështetjen që institucionet gjermane, si autoriteti homolog federal dhe ato të landeve, ashtu si dhe vetë ambasada e RFGJ në Tiranë, kanë dhënë ndër vite për Zyrën e Komisionerit. Gjatë takimit, Ambasadori Zingraf u njoh me rolin, funksionet dhe

veprimtarinë e autoritetit, si dhe me zbatimin e Projektit të Binjakëzimit për përafrimin e legjislacionit evropian të mbrojtjes së të dhënave - GDPR dhe Direktivën e Policisë, në atë kombëtar. Në takim u përcaktuan objektivat e bashkëpunimit dhe mbështetjes për zbatimin e projekteve në të ardhmen.

TAKIMI I 21-TË I CEEDPA

Zyra e Komisionerit mori pjesë në takimin e 21-të të Rrjetit të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEDPA). Kjo konferencë, e zhvilluar virtualisht në dy ditë, mbledhi bashkë përfaqësues të institucioneve të kësaj fushe nga 19 shtetet anëtare të organizatës. Diskutimi u përqendrua në tematikat mbi shkëmbimin e eksperiencave më të mira në lidhje me mekanizmat e përgjegjshmërisë në përpunimin e të dhënave personale; revolucionin e pandemisë, si të mbrohen të dhënat në botën post-Covid 19; zbatimin e standardeve të Bashkimit Evropian (BE) dhe Këshillit të Evropës (KiE) në mbrojtjen e të dhënave dhe shkëmbimi i tyre ndërkufitar; si dhe mbrojtja më e mirë e të dhënave personale të fëmijëve, parimet kryesore dhe sfidat.

Zyra e Komisionerit u përfaqësua në dy panelet e fundit, ku solli përvojën e saj në procesin e përafrimit të GDPR dhe Direktivës së Policisë me legjislacionin shqiptar, nëpërmjet zbatimit të Projektit të Binjakëzimit. Po ashtu, u prezantua dhe aktiviteti institucional në kuadër të ndërgjegjësimit dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së të dhënave të tyre personale në mjedisin digjital. Ky takim përkoj edhe me jubileun e 20-vjetorit të këtij Rrjeti të krijuar me iniciativën e Autoritetit të Polonisë.



FORCIMI I BASHKËPUNIMIT ME AUTORITETIN HOMOLOG TË KOSOVËS

Me ftesë të Komisioneres së Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), znj. Krenare Sogojeva-Dërmaku, Komisioneri z. Besnik Dervishi zhvilloi një vizitë pune në Prishtinë.

Në këtë takim, i pari që pas marrjes së detyrës nga znj. Sogojeva-Dërmaku, u vlerësua niveli i lartë dhe i veçantë i marrëdhënies mes institucioneve, ndërsa u diskutua për mundësitë konkrete për forcimin e saj. Palët ranë dakord që të angazhohen në hartimin e një marrëveshje, si një instrument gjithëpërfshirës bashkëpunimi afatgjatë.



Gjithashtu, u theksua se duhen shtuar kontaktet mes stafeve të autoriteteve, në mënyrë që të shkëmbehet eksperiencia më e mirë për rritjen e standardeve të zbatimit si të legjislacionit të të drejtës për informim, ashtu edhe atij për mbrojtjen e të dhënave personale. Komisionerët, ndanë të njëjtin qëndrim për shfrytëzimin e të gjitha mundësive për mbështetjen e

autoritetit të Kosovës, në kuadër të pjesëmarrjes në organizatat rajonale e ndërkombëtare në të dy këto fusha.

Komisioneri Dervishi zhvilloi një takim edhe me Avokatin e Popullit, z. Naim Qelaj. Në të u diskutua për sfidat e njëjta në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe për mundësitë e zgjerimit të bashkëveprimit në promovimin e praktikave më të mira në këtë sferë. Në këtë takim u soll përvoja e suksesshme e marrëveshjes së bashkëpunimit mes institucioneve të të drejtave të njeriut në Shqipëri – Avokati i Popullit, Zyra e Komisionerit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një model që mund të ndiqet edhe nga autoritetet që ushtrojnë këto funksione në Kosovë.



TRANSPARENÇË NË VEPRIMTARINË E PROKURORISË



“Komunikimi efektiv me median dhe publikun, garanci për mirëfunksionimin e institucioneve të drejtësisë” ishte tema e trajnimit të organizuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Misioni PAMECA V (Misioni i asistencës së BE për institucionet shqiptare të zbatimit të ligjit). Zyra e Komisionerit i njohu të pranishmit me legjislacionin e kësaj fushe dhe me funksionet e autoritetit. Vëmendje iu kushtua përditësimit të Programit të Transparençës, si një instrument i


rëndësishëm në informimin e publikut dhe rolit të koordinatorit në procesin e trajtimit të kërkesave. U diskutua për çështje nga praktika në raport me veprimtarinë e prokurorisë apo institucioneve të zbatimit të ligjit, si dhe u trajtuan edhe rastet e kufizimit të të drejtës për informim. Të pranishëm të trajnim ishin prokurorët e ngarkuar për komunikimin me median nga të gjitha prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, koordinatorët për të drejtën e informimit të këtij institucioni, si dhe përfaqësues të mediave.

NJOHJA DHE NDËRGJEGJËSIMI PËR USHTRIMIN E TË DREJTAVE, TAKIM ME GJIMNAZISTË

Në Zyrën e Komisionerit u zhvillua takimi me një grup nxënësish të gjimnazeve të Tiranës, në kuadër të projektit “Act on Hate” (“Vepr kundë urrejtjes”) që zbatohet nga Qendra “Act for Society” (“Vepra për shoqërinë”). Të rinjtë shfaqën interes për veprimtarinë e institucionit, veçanërisht, për fushën e mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale në mjedisin digjital e në rrjetet sociale. Ata u njohën me legjislacionin, rolin dhe funksionet e autoritetit, si dhe me aktivitetet e zhvilluara ndër vite në të gjithë vendin, kryesisht, me nxënës e mësues të arsimit parauniversitar. Pjesëmarrësve iu prezantuan materiale/botime ndërgjegjëse dhe se si të përdorin informacionet nga faqja zyrtare e internetit të institucionit. Projekti “Act on Hate” ka për qëllim të ndikoj në ndryshimin pozitiv të sjelljes së të rinjve në zonat periferike të Tiranës, si kontribut në luftën kundër gjuhës së urrejtjes.



BALANCA MES DYTË DREJTAVE NË VEPRIMTARINË E AUTORITETEVE PUBLIKE TË SEKTORIT SHËNDETËSOR



Transparencë ndaj publikut duke garantuar respektimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve. Ishte kjo tema e trajnimit të zhvilluar me koordinatorët për të drejtën e informimit dhe personat e kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale të Autoriteteve Publike që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin shëndetësor. Në aktivitetet u trajtuan çështje të zbatimit të kuadrit ligjor në vlerësim të balancuar mes dy të drejtave, si dhe për problematikat e

hasura në raport me përballimin e situatës së pandemisë Covid-19. Vëmendje iu kushtua plotësisht dhe përditësimit të rubrikave të Programit të Transparencës për forcimin e transparencës proaktive, duke rritur cilësinë e informacionit për publikun. Gjithashtu, u trajtuan ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale shëndetësore, të cilat kategorizohen si sensitive dhe për to garantohen një nivel më i lartë mbrojtjeje. Ndërsa, u diskutua edhe për trajtimin e kërkesave të subjekteve të të dhënave (*individët*), si dhe për rolin e funksionet e personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale në këtë proces.

BASHKËPUNIM ME IAL PËR NDËRGJEGJËSIMIN E STUDENTËVE

Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar me institucione publike të arsimit të lartë (IAL) apo organizata studentore për rritjen e ndërgjegjësimit për ushtrimin në praktikë të të drejtave të qytetarëve. U zhvilluan trajnime/takime për njohjen e legjislacionit të zbatueshëm në të dy fushat e kompetencës së institucionit. Në to morën pjesë kryesisht studentë, por edhe staf akademik e administrativ nga Universitetet “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, “Aleksandër Moisiu” të Durrësit, “Fan Noli” të Korçës dhe anëtarë të Klubit Studentor nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës. Pjesëmarrësit në takime u njohën me rolin, funksionet dhe veprimtarinë e autoritetit për mbikëqyrjen e zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi. Vëmendje iu kushtua aspekteve për forcimin e transparencës proaktive të Autoriteteve Publike dhe rritjes së përgjegjshmërisë në përpunimin e të dhënave personale nga kontrollues publik e privat.



“EDUKIMI DIGJITAL, LUAJ DHE MËSO – HAPPY ONLIFE”, FUSHATA KOMBËTARE PËR NDËRGJEGJËSIMIN E NXËNËSVE



Zyra e Komisionerit përmbylli Fushatën Kombëtare “Edukimi digjital, luaj dhe mëso – Happy onlife”. Kjo iniciativë u zhvillua për ndërgjegjësimin e nxënësve të arsimit 9-vjeçar për lundrimin e sigurt në mjedisin digjital.

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2021 u mbajtën 20 takimet e fazës së tretë në shkolla të qyteteve të Pukës, Fushë Arrëzit, Përrenjasit, Pogradecit, Memaliajt, Tepelenës, Gjirokastrës, Përmetit, Tiranës,

Orikumit, Himarës, Sarandës, Delvinës, Fierit, Roskovecit, Vlorës dhe Selenicës. Nëpërmjet lojës “Happy Onlife” nxitet i menduari kritik e analitik për përdorimin e të dhënave personale në rrjet. Në këto takime u bashkëbisedua dhe u ndanë informacione e këshilla praktike për aftësimin e grup-moshës 12-15 vjeç, sidomos, për sjelljet që duhet të përshtatin gjatë përdorimit të rrjeteve sociale dhe parandalimin e fenomeneve negative. Në kuadër të këtij projekti u mbajtën gjithsej 55 takime, morën pjesë më shumë se 1000 nxënës të klasave të 6/7/8-ta, si dhe mësues të lëndëve të gjuhës angleze, informatikës apo qytetarisë. Zyra e Komisionerit vlerëson dhe falënderon për bashkëpunimin në koordinimin e realizimit të kësaj Fushate Kombëtare Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe strukturat e saj të varësisë, si dhe partnerët e projektit.



2022

Zyra e Komisionerit ju uron Gëzuar!



1
100
00000
0100000
000100000
0000000
001000100
00000100010
0010010010000
010001000000100
0010000100000
000001000001000
10010000001000000
0100010000100011000
0001000001000100000000

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

INFORMATION AND
DATA PROTECTION
COMMISSIONER


Revista “Informim Dhe Privatësi”

Përgatitet dhe botohet nga

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit

dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Dhjetor 2021



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

**Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5
Kodi postar 1001
Tiranë**

**Tel: +355 42237200
Nr. i gjelbër: 08002050
www.idp.al
info@idp.al**